

# UDHËZUES PËR PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR PËRFSHIRJEN AKTIVE TË AKTIVISTËVE TË RINJ DHE ORGANIZATAVE RINORE NË PROCESET E **MBROJTJES** **SË MJEDISIT JETËSOR NË NIVEL LOKAL**



# Udhëzues për praktikat më të mira për përfshirjen aktive të aktivistëve të rinj dhe organizatave rinore në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel lokal

## Botues:

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë (ShJRM)

## Autor:

Petar Barllakovski, kryetar i Forumit Arsimor të Maqedonisë (FAM)  
dhe delegat i ri i OKB-së

## Redaktore:

Angella Shumkoska

## Lektor:

Vesna Kostovska

## Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi:

Valon Abdiu

## Dizajni artistik dhe grafik:

Haris Muriq

## Shkup, 2023

CIP - Katalogizacija vo publikacija  
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

323.21-053.6:[352.077:502.17(497.7)(083.13)  
323.21-053.6:[352.077:502.17(4-672EY)(083.13)

BARLLAKOVSKI, Petar

Udhëzues për praktikat më të mira për përfshirjen aktive të aktivistëve të rinj dhe organizatave rinore në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel lokal [Електронски извор] / [autor Petar Barllakovski ; përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi Valon Abdiu]. - Shkup : Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2023

Начин на пристапување (URL):

[https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2023/05/Udhezues-per-praktikat-me-te-mira-per-perfshirjen-aktive-te-aktivisteve-te-rinj-dhe\\_compressed.pdf](https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2023/05/Udhezues-per-praktikat-me-te-mira-per-perfshirjen-aktive-te-aktivisteve-te-rinj-dhe_compressed.pdf)  
(Слободен пристап). - Текст во PDF формат, содржи 28 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 12.05.2023.  
- Фусноти кон текстот. - Содржи и: Анекс 1-3

ISBN 978-608-4843-79-5

а) Животна средина -- Заштита -- Младинско учество -- Локална самоуправа  
-- Македонија -- Упатства б) Животна средина -- Заштита -- Младинско  
учество -- Локална самоуправа -- Европска Унија -- Упатства

COBISS.MK-ID 60340229

*Vërejtje: Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.*

*Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e plotë e autorit dhe e Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohet se e pasqyron qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.*



**МЛАДИНСКИ  
АКТИВИЗАМ**  
#ЗА ПОЗЕЛЕНИ ОПШТИНИ



МЗМП



GoGreen



# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. Hyrje</b>   | <b>1</b>  |
| 1.1. Cili është qëllimi i këtij udhëzuesi dhe për kë është i dedikuar ai?   | 2         |
| 1.2. Metodologjia dhe qasja metodologjike   | 3         |
| <b>2. Pasqyrë krahasuese e pjesëmarrjes së të rinjve në lidhje me proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel lokal</b>   | <b>4</b>  |
| 2.1. Këshilli Rinor Danez për Ndryshimet Klimatike  | 4         |
| 2.2. Këshilli Rinor Austriak për Ndryshimet Klimatike   | 5         |
| 2.3. Delegatë të rinj të specializuar për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor   | 5         |
| 2.4. Aktivitete lokale me të rinjtë në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike  | 6         |
| 2.5. Bashkëpunim me forumet rinore partiake të partive të gjelbra   | 6         |
| <b>3. Pasqyrë e akteve ligjore kombëtare që e rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve/të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor</b> | <b>7</b>  |
| 3.1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut  | 7         |
| 3.2. Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore  | 7         |
| 3.3. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale  | 9         |
| 3.3.1. Kompetenca e komunës   | 9         |
| 3.3.2. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në vendimmarrje  | 9         |
| - Iniciativa qytetare   | 9         |
| - Tubimi i qytetarëve   | 9         |
| - Referendumi   | 10        |
| - Parashtresat dhe propozimet   | 10        |
| 3.4. Ligji për Mjedisin Jetësor   | 10        |
| 3.4.1. Raporti për gjendjen e mjedisit jetësor  | 10        |
| 3.4.2. Plani lokal i veprimit për mjedisin jetësor  | 11        |
| 3.5. Ligji për Mbikëqyrjen Inspektuese në Mjedisin Jetësor  | 12        |
| <b>4 Si mund të përfshihen të rinjtë në mënyrë aktive në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel lokal?</b>   | <b>13</b> |
| 4.1.1. Përshkrimi i shkallës së pjesëmarrjes së të rinjve   | 14        |
| 4.1.2. Hapat për zgjidhjen e problemit në komunën time  | 15        |
| 4.1.3. Mjete kreative për aktivizëm të gjelbër rinor  | 19        |
| <b>5. Shtojcat</b>  |           |
| 5.1.1 – Shembull i parashtresës me shkrim – Kërkese   | 22        |
| 5.1.2 – Formulari për dorëzimin e parashtresës / reagimit   | 23        |
| 5.1.3 – Kërkese për qasje në informatat me karakter publik  | 24        |



# 1. HYRJE



„M'i vodhët ëndrrat e mia dhe fëmijërinë time me fjalët e tuaja boshe. E megjithatë unë jam njëra nga ato me fat. Njerëzit vuajnë. Njerëzit vdesin. Ekosisteme të tëra po shemben. Jemi në fillimin e një zhdukjeje masive dhe gjithçka që bëni është të flisni për para dhe përralla për rritjen e përvetshme ekonomike. Si guxoni?!



Greta Thunberg, shtator 2019

Kjo është pjesë e fjalimit të së resë Greta Thunberg në Samitin Botëror të Veprimit Klimatik që u mbajt në shtator të vitit 2019 në Nju Jork. Greta Thunberg është një aktiviste e re me famë botërore, e cila me aktivizmin e saj ekologjik arriti të mobilizojë mijëra të rinj në mbarë botën, me qëllim të rritjes së presionit ndaj autoriteteve ndërkombëtare dhe kombëtare në drejtim të përpjekjeve më të mëdha në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Aktivizmi i gjelbër i aktivistes së re suedeze padyshim që reflektoi edhe te të rinjtë e vendit tonë dhe ata, sikurse edhe bashkëmoshatarët e tjerë të tyre nga e gjithë bota, e kuptuan urgjencën e situatës dhe theksuan pse është e rëndësishme të reagohet dhe të bëhet presion mbi autoritetet kombëtare dhe lokale.

Sipas përkufizimit të Kombeve të Bashkuara, ndryshimet klimatike i referohen ndryshimeve afatgjata të temperaturave dhe fenomeneve të motit. Këto ndryshime mund të jenë të natyrshme, por që nga shekulli i 19-të, aktivitetet njerëzore kanë qenë nxitësi dhe shkaktari kryesor i ndryshimeve klimatike, kryesisht për shkak të djegies së lëndëve djegëse fosile (të tilla si qymyri, nafta dhe gazi), të cilat lëshojnë gazra serë që e bllokojnë nxehtësinë. Ndryshimet klimatike, si të tilla, kanë ndikim të madh në jetën e përditshme të njerëzve. Rritja e temperaturave, stuhitë gjithnjë e më të shpeshta, si dhe zjarret, janë pasoja të drejtpërdrejta të ndryshimeve klimatike. Këto ndryshime klimatike kanë ndikimin e tyre në të gjitha sferat e shoqërisë dhe jo vetëm që kanë pasoja ekonomike, shëndetësore dhe arsimore, por pasojat shfaqen edhe në sferën sociologjike dhe juridike. Për të mbrojtur më mirë mjedisin jetësor dhe për t'u përballë me pasojat e ndryshimeve klimatike, institucionet kombëtare dhe lokale, sektori privat, shoqëria civile kanë rol kyç, dhe për rrjedhojë shfaqet nevoja për një qasje ndër-disiplinore dhe gjithëpërfshirëse për të zgjidhur problemin kryesor.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, situata me mbrojtjen e mjedisit jetësor nuk është aspak e shkëlqyer. Vendi ende përballlet me probleme të mëdha që lidhen me mjedisin jetësor – rritje të ndotjes së ajrit, mungesë e infrastrukturës për menaxhimin e drejtë të mbeturinave dhe për mbrojtjen e natyrës. Kjo vihet në dukje edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian, konkretisht në kapitullin 29 , ku thuhet se:

**"...kapaciteti administrativ në të gjitha nivelet mbetet i dobët me burime të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për të zbatuar dhe ekzekutuar legjisllacionin ekzistues.<sup>2</sup> Inspektimet që kryhen kanë pak efekt. Nuk ka përmirësim në zbatimin e Vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor, me mangësi veçanërisht në proceset e konsultimeve publike dhe në cilësinë e raporteve. Mungesa e transparencës dhe qasjes në informata vazhdojnë të mbeten çështje të pazgjidhura".**

1 Raportin mund ta gjeni në këtë link: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#.ZDxMxLpBwUF>

2 Trashja e fjalisë është bërë nga autori i udhëzuesit.

Mungesa e konsultimeve publike lidhur me hartimin e politikave paraqitet si problem kyç, i cili përveç që është theksuar në Raportin e KE-së, konfirmohet edhe nga hulumtimi i fundit<sup>3</sup> i Forumit Arsimor Rinor (FAR) dhe i Fondacionit Westminster për Demokraci, ku thuhet se "69,4% e të rinjve nuk janë konsultuar asnjëherë nga autoritetet as në nivel lokal, e as në atë qendror". Nga ajo që u tha më sipër, mund të konkludohet se në vendin tonë mungon konsultimi publik dhe përfshirja aktive e të rinjve në proceset e hartimit të politikave si grup specifik demografik.

Të rinjtë llogariten si kategori e cenueshme nga ndryshimet klimatike dhe janë një nga grupet më të prekura, por edhe më aktive, që e ngrenë zërin në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor në nivel botëror, rajonal, kombëtar dhe lokal. Duke pasur parasysh se pasojat e ndryshimeve klimatike do të reflektohen më së shumti në jetën e atyre që momentalisht janë të rinj, është thelbësore pjesëmarrja e të rinjve në proceset e hartimit të politikave në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, të njohura edhe si politika të gjelbra<sup>4</sup>. Autoritetet duhet të kenë veçanërisht parasysh faktin se pjesëmarrja e të rinjve është, mbi të gjitha, një e drejtë që u mundëson të rinjve të konsultohen dhe të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes që kanë të bëjnë me ta dhe që i prekin drejtpërdrejt ata dhe shoqërinë në tërësi.

Duhet pasur parasysh se të rinjtë nuk përfaqësojnë një grup homogjen dhe se është e rëndësishme të merren parasysh mendimet dhe të përfshihen të rinj me prejardhje të ndryshme gjatë krijimit të politikave, pavarësisht nëse janë të rinj me aftësi të kufizuara, të rinj nga zonat rurale apo të rinj nga komunitetet e tjera të marginalizuara, me qëllim të krijimit të proceseve gjithëpërfshirëse të disponueshme për të gjithë.

Në fund, sipas fjalëve të përfaqësueses speciale për të rinjtë të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, "**autoritetet dhe vendimmarrësit duhet domosdoshmërisht t'i njohin idetë, zgjidhjet dhe ekspertizën që të rinjtë e sjellin në tryezë, në mënyrë që pjesëmarrja dhe përfshirja e tyre të përfitojë nga procesi dhe të përfaqësojë një përvojë kuptimplote dhe të vlefshme**".

## 1.1. CILI ËSHTË QËLLIMI I KËTIJ UDHËZUESI DHE PËR KË ËSHTË I DEDIKUAR AI?

Ky udhëzues, para së gjithash, është i dedikuar për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht për aktivistët e rinj, organizatat rinore, organizatat civile për të rinjtë dhe organizatat civile që punojnë me të rinjtë, të cilët veprojnë, gjegjësisht dëshirojnë të veprojnë dhe të kontribuojnë në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ky udhëzues përmban informacion mbi praktikën më të mira për përfshirjen aktive të të rinjve në procesin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, praktika që janë marrë parasysh nga vendet më të zhvilluara, anëtare të BE-së, dhe shtetet që udhëheqin me pjesëmarrjen e të rinjve në proceset që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Gjithashtu, udhëzuesi përmban edhe një pasqyrë të akteve ligjore kombëtare që e rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor, që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe një pasqyrë të institucioneve që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të udhëzuesit, të rinjtë, gjegjësisht organizatat rinore, mund të njihen edhe me mënyrat e përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse, para së gjithash, përmes aktit kyç ligjor që e rregullon pjesëmarrjen e të rinjve në shtet - Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore, por dhe nëpërmjet praktikave dhe mënyrave të tjera formale dhe joformale që të rinjtë dhe organizatat rinore mund t'i marrin parasysh në dëshirën e tyre për të marrë pjesë aktive në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Së fundi, brenda udhëzuesit mund të gjenden edhe formularë nga dokumente të ndryshme - **Kërkesë për qasje në informata me karakter publik, Ankesë, Parashtrësë** që mund t'u ndihmojnë aktivistëve/organizatave në aktivizmin e tyre lokal për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

3 Hulumtimi i plotë gjendet në këtë link: <https://mof.mk/wp-content/uploads/2021/08/Studija-Socio-Politicko-Ucestvo-na-Mladi-2021-MK-sml-1.pdf>

4 Politikat e gjelbra janë politika që synojnë të mbrojnë mjedisin jetësor, të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ofrojnë zgjidhje që do ta reduktojnë ndikimin e ndryshimeve klimatike.

## 1.2. METODOLOGJIA DHE QASJA METODOLOGJIKE

Në procesin e krijimit të këtij udhëzuesi, u bë një analizë në zyrë, një intervistë dhe një pyetësor anketues që u shpërnda midis aktivistëve të rinj, gjegjësisht delegatëve rinorë të vendeve të tyre në OKB dhe u mbajt një fokus grup me përfaqësues të zyrtarëve rinorë nga njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe përfaqësues të organizatave rinore dhe organizatave rinore.

Për sa i përket analizës në zyrë, u analizuan dispozitat përkatëse që e rregullojnë materien që lidhet me: 1) mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike, 2) pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, si dhe 3) pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe organizimin e të rinjve në nivel kombëtar dhe lokal. Nga këto dispozita ligjore, u nxorën ato pjesë që autori i konsideroi si më të rëndësishmet për udhëzuesin për sa i përket normave ligjore që mund t'u ndihmojnë aktivistëve të rinj dhe organizatave rinore në drejtim të aktivizimit më të madh për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike në nivel lokal.

### 1 Dispozitat që e rregullojnë materien që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit jetësor:

- Në këtë pjesë, fillimisht u analizua *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si akti më i lartë juridik që e parasheh mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe mjetet dhe format e drejtpërdrejta të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Gjithashtu, është bërë një analizë dhe rishikim i Ligjit për Mjedisin Jetësor, si dhe i Ligjit për Mbikëqyrjen Inspektuese në Mjedisin Jetësor.*

### 2 Dispozitat që e rregullojnë materien që ka të bëjë me pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse:

- Në këtë pjesë është analizuar *Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ku janë shpjeguar mjetet dhe mënyrat e drejtpërdrejta për pjesëmarrjen e qytetarëve.*

### 3 Dispozitat që e rregullojnë materien që ka të bëjë me pjesëmarrjen e të rinjve:

- Në këtë pjesë është analizuar *Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, si ligj thelbësor që e rregullon pjesëmarrjen e të rinjve në nivel kombëtar dhe lokal.*

Sa i përket pyetësorit anketues, ai u krijua me ndihmën e "Google Forms" dhe përbëhej nga dy pjesë - të dhëna të përgjithshme për të anketuarin dhe pjesa e dytë që ishte një pyetje, gjegjësisht: Si i përfshin vendi juaj të rinjtë në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë ndryshimet klimatike? (How does your country include young people in decision-making processes regarding climate change?) Pyetja ishte e hapur për t'u dhënë liri të plotë të anketuarve ta japin përgjigjen e tyre. Pyetësi ishte i hapur nga data 10 deri më 31 janar. Ai u nda me një grup joformal të delegatëve të rinj në kuadër të OKB-së. Pyetësori iu përgjigjën 5 delegatë, edhe atë konkretisht nga Austria, Belgjika, Luksemburgu, Sllovakia dhe Zvicra. Gjithashtu, u zhvillua edhe një intervistë e shkurtër me delegatin e të rinjve të BE-së në OKB.

Fokus grupi u mbajt online në platformën "ZOOM". Ai përmbante një prezantim të Udhëzimeve për praktikata më të mira me qëllim përfshirjen aktive të aktivistëve të rinj dhe organizatave rinore në proceset e mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal në një version draft. Qëllimi kryesor i mbajtjes së fokus grupit ishte që përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes lokale si dhe përfaqësuesit e organizatave rinore të kontribuojnë në procesin e finalizimit të udhëzimeve.

## 2. PASQYRË KRAHASUESE E PJESËMARRJES SË TË RINJVE NË LIDHJE ME PROCESET E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR NË NIVEL LOKAL

### 2.1. Këshilli Rinor Danez për Ndryshimet Klimatike

Këshilli Rinor Danez për Ndryshimet Klimatike është një organ në kuadër të Ministrisë së Klimës, Energjisë dhe Shërbimeve Komunale. Këshilli Rinor për Ndryshimet Klimatike sjell perspektiva të reja në politikën daneze për ndryshimet klimatike dhe i paraqet propozime Ministrisë për zgjidhjet e ardhshme klimatike. Gjithashtu, Këshilli Rinor për Ndryshimet Klimatike përgatit rekomandime për ministrin dy herë në vit, ndërsa më parë ka paraqitur rekomandimet e veta lidhur me sektorin e energjisë, bujqësinë e qëndrueshme, Detin e Veriut etj. Anëtarët e Këshillit Rinor për Ndryshimet Klimatike emërohen për një periudhë njëvjeçare dhe vijnë nga të gjitha pjesët e Danimarkës, nga fusha të ndryshme studimi dhe kanë qasje të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ideja për këtë këshill erdhi nga delegatët e rinj që morën pjesë në Konferencën e Palëve Nënshkruese të Konferencës Kornizë për Ndryshimet Klimatike të OKB-së (Conference of Parties, e njohur edhe si COP)<sup>5</sup> në Poloni.

Prandaj, kjo është një ide e shkëlqyer për aktivistët e rinj të gjelbër, si dhe për organizatat rinore që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, për të nisur një proces me të cilin do të iniciojnë formimin e një këshilli të tillë pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor, ku do të formohet një organ formal i përbërë nga të rinj, dhe i cili do të paraqesë rekomandime dhe iniciativa deri te ministria me qëllim të trajtimit më serioz të problemit të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.

Në momentin e shkrimit të këtij udhëzuesi është duke u hartuar Ligji për Veprimin Klimatik, i cili parashikon krijimin e Këshillit Koordinues Kombëtar për Veprimin Klimatik. Ky Këshill Kombëtar Koordinues parashikohet si një mekanizëm përmes të cilit do të jepen udhëzime, mendime dhe rekomandime për veprimet e përgjithshme klimatike që ndërmerren në nivel kombëtar, të cilat do ta lehtësojnë zbatimin e veprimeve klimatike dhe do të kontribuojnë në integrimin e veprimeve klimatike në politikat, planet dhe masat sektoriale, me theks të veçantë në integrimin e politikave të energjisë dhe atyre klimatike. Si anëtarë të përhershëm në këtë Këshill Kombëtar është paraparë të ketë një përfaqësues nga sektori i shoqërisë civile, me mundësinë e një përfaqësuesi shtesë nga sektori i rinisë.

Duke marrë parasysh këtë informacion, organizatat rinore që merren me politikat e gjelbra dhe, në përgjithësi, që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike, mund ta theksojnë shembullin e Danimarkës si një praktikë e mirë e përfshirjes së të rinjve në proceset e krijimit të politikave të gjelbra.

5 Më shumë për COP mund të gjeni në këtë link: <https://unfccc.int/process/bodies/supreme-bodies/conference-of-the-parties-cop>

## 2.2. Këshilli Rinor Austriak për Ndryshimet Klimatike

Ashtu si Danimarka, edhe Austria ka Këshill Rinor për Ndryshimet Klimatike. Ky organ funksionon në kuadër të Këshillit Rinor Kombëtar të Austrisë. Organi financohet nga Këshilli Rinor Kombëtar, por edhe nga ana e qeverisë austriake. Ai përbëhet nga rreth 70 të rinj nga i gjithë vendi, të cilët në disa seanca gjatë vitit debatojnë në lidhje me propozime të caktuara që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike, e më pas ato u prezantohen deputetëve të të gjitha partive në Austri.

Duke pasur parasysh këtë, Këshilli Rinor Kombëtar i Maqedonisë, si organizata më e madhe ombrellë rinore në vend, si dhe anëtarët e tij mund ta ndjekin shembullin e të rinjve nga Austria dhe të iniciojnë formimin e Këshillit Rinor për Ndryshimet Klimatike në kuadër të Këshillit Rinor Kombëtar të Maqedonisë. Ky organ mund të paraqesë fillim për një përfshirje më të madhe të të rinjve dhe të organizatave rinore në proceset vendim-marrëse që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

## 2.3. Delegatë të rinj të specializuar për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor

Një pjesë e madhe e vendeve evropiane, përveç që kanë paraparë delegatë të rinj për pjesëmarrje në punën e Kombeve të Bashkuara, kanë edhe delegatë të rinj për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Roli i këtyre delegatëve të të rinjve është të marrin pjesë në ngjarje dhe konferenca të rëndësishme në mbarë botën, si p.sh. në COP, e të cilat kanë të bëjnë me luftën kundër mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike. Në këto ngjarje botërore ata i prezantojnë problemet, iniciativat dhe propozimet e të rinjve nga vendi i tyre, e ata janë anëtarë të delegacionit zyrtar të vendit që e përfaqësojnë dhe, më e rëndësishmja, marrin pjesë në krijimin e politikave në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu, këta delegatë të rinj janë aktivë edhe në nivel lokal, ku përveç pjesëmarrjes në ngjarje dhe konferenca të ndryshme që kanë të bëjnë me këtë temë, organizojnë drejtpërdrejt ngjarje, konsultime dhe diskutime me të rinjtë dhe me institucionet në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Duke pasur parasysh se në R. të Maqedonisë së Veriut ka dy vite me radhë një program të delegat të të rinjve në OKB, organizatat rinore së bashku me institucionet tjera relevante, siç janë Agjencia për Rini dhe Sport, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Punëve të Jashtme, duhet të bëjnë përpjekjet për pjesëmarrje më të madhe delegatit të të rinjve në proceset që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel ndërkombëtar, ose ndoshta mund ta ndjekin shembullin e vendeve të tjera, siç janë Suedia, Austria dhe Gjermania, dhe të krijojnë një program të veçantë për delegatët e rinj të specializuar për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në Sllovaki, anëtar i delegacionit zyrtar të Presidentit të Shtetit në COP27 ishte edhe delegati i të rinjve, i cili pas përfundimit të konferencës paraqiti një listë masash dhe rekomandimesh që duhet të ndërmerren nga vetë Presidenti dhe nga vetë shteti. Ky është një shembull i shkëlqyer i pjesëmarrjes së të rinjve në nivelin më të lartë politik kur bëhet fjalë për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.



## 2.4. Aktivitete lokale me të rinjtë në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike

Një nga praktikat e përmendura nga të rinjtë në BE në lidhje me angazhimin më të madh të të rinjve në lidhje me politikat e gjelbra dhe, në përgjithësi, përfshirjen e tyre, është edhe konsultimi lokal me të rinjtë e komunitetit të tyre. Në Austri, delegatë e të rinjve në OKB, mirëpo edhe organizatat rinore, organizojnë konsultime lokale me të rinjtë në komunitetet e tyre, ku diskutojnë lidhur me problemet me të cilat përballen ata të rinj për sa i përket mjedisit jetësor. Në këto konsultime, përveç të rinjve nga komuniteti, mund të ftohen edhe përfaqësues të pushtetit lokal, të cilët do t'i dëgjojnë drejtpërdrejt problemet e të rinjve, por edhe idetë e tyre. Si rezultat i konsultimeve të organizuara lokale dhe i debateve të zhvilluara, përpilohen dhe dorëzohen rekomandime specifike për autoritetet lokale në lidhje me atë se çfarë duhet bërë në periudhën e ardhshme. Përveç kësaj, në disa nga vendet e BE-së organizohen edhe konferenca lokale të gjelbra për të rinjtë. Këto konferenca rinore janë një forum i shkëlqyer për shkëmbimin e ideve, për diskutimin dhe krijimin e propozim-zgjidhjeve që organizatat rinore duhet t'i marrin në konsideratë. Ky lloj ngjarjesh të specializuara për të rinjtë dhe ndryshimet klimatike janë një mundësi për edukim dhe informim më të madh të të rinjve lidhur me këto tema, por mbi të gjitha, një mundësi më e madhe për ndikim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Në këto konferenca të gjelbra mund të organizohen debate, panele dhe diskutime të ndryshme me vendimmarrësit.

Këshillat rinorë lokalë, të cilët sipas Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikave Rinore duhet të krijohen në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në vend, paraqesin një forum të shkëlqyer për konsultime me të rinjtë lidhur me këtë çështje. Këto konsultime pastaj mund të kalojnë në hapa konkretë që do të ndërmerren nga Këshilli Rinor Lokal në përputhje me kompetencat e tij. Më shumë për kompetencat e Këshillit Rinor Lokal në Kapitullin 3.

## 2.5. Bashkëpunim me forumet rinore partiake të partive të gjelbra

Një nga praktikat që e ndanë delegatët e të rinjve është edhe bashkëpunimi me forumet rinore partiake të partive të gjelbra. Në pjesën më të madhe të vendeve evropiane, partitë e gjelbra paraqesin parti me fuqi të konsiderueshme dhe me një trup votues të madh. Forumet rinore të këtyre partive politike shpesh bashkëpunojnë me organizatat rinore, si dhe me aktivistë rinorë në drejtim të mbajtjes së konsultimeve dhe bashkëpunimit të rregullt për krijimin e politikave dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Në Maqedoni ekziston një parti parlamentare e gjelbër, dhe ajo është Partia Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë, gjegjësisht RDM (DOM në maqedonisht, v.p.). Në kuadër të RDM-së ekziston edhe forum rinor, përkatësisht Organizata Rinore e RDM-së, gjegjësisht ORRDM. Ky forum rinor është anëtar i Federatës së të Gjelbërve të Rinj Evropianë, që është forumi rinor i Partisë së Gjelbër Evropiane, si dhe është themelues dhe anëtar i Këshillit Rinor Kombëtar të Maqedonisë.

Shembull i bashkëpunimit të suksesshëm me forumet rinore partiake është projekti “Eko-aktivizmi rinor për komunitet e gjelbra”, i zbatuar nga “Go Green”, organizatë rinore që punon në fushën e politikave të gjelbra. Aktivitetet fillimisht u realizuan duke nënshkruar memorandume me forumet rinore partiake për të vendosur bashkëpunim me kandidatin për kryetar komune nga partia e tyre në ato komuna.

Nëpërmjet memorandumeve të nënshkruara, kryetarët e komunave u zotuan se do të bashkëpunojnë me të rinjtë për tema si mjedisi jetësor, ndryshimet klimatike dhe pjesëmarrja e të rinjve. Disa nga komunitet iu përgjigjën pozitivisht kërkesave të të rinjve dhe zbatuan disa nga zgjidhjet, si p.sh. shtegu për biçikleta në Kisella Vodë, shtyllat mbrojtëse në trotualet në Komunën e Aerodromit, ndërsa në realizim e sipër është kopshti në çerdhen në Komunën e Çairit.

### 3. PASQYRË E AKTEVE LIGJORE KOMBËTARE QË E RREGULLOJNË PJESËMARRJEN E QYTETARËVE/TË RINJVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE NË NIVEL LOKAL LIDHUR ME MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

#### 3.1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

*Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut është akti më i lartë juridik i shtetit. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se në mënyrë hierarkike është i vendosur mbi të gjitha ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe se të gjitha ligjet dhe aktet e tjera duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.*

Mjedisi jetësor përmendet për herë të parë në Kushtetutën e vendit në nenin 8, gjegjësisht në vlerat themelore të vetë aktit, ku thuhet se një nga vlerat themelore është "rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës". Prandaj, mund të konstatohet se hartues i kushtetutës sonë, përkatësisht shteti, mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor e konsideron si synim dhe vlerë të një rëndësie të jashtëzakonshme.

Dispozita më thelbësore në Kushtetutë, e cila i referohet mjedisit jetësor, është neni 43, sipas të cilit "**Çdo njeri ka të drejtë për mjedis të shëndetshëm jetësor. Secili e ka për detyrë ta përparojë dhe ta mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndetshëm jetësor**". Sipas kësaj, mund të konkludohen dy gjëra – e para është se një mjedisi i shëndetshëm është e **drejtë** e çdo njeriu dhe e dyta është se çdo person ka **obligim** të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

#### 3.2. Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore

Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore është një ligj kyç dhe thelbësor që e rregullon pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e miratimit të politikave. Me këtë ligj, të rinjve në vend u jepet e drejta ligjore për përfshirjen e tyre në nivel kombëtar dhe lokal, por, gjithashtu parashikon edhe detyrim institucional për përfshirjen e të rinjve në proceset e ndërtimit dhe krijimit të politikave. Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimarrëse në nivel lokal, e veçanërisht në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor, para së gjithash është thelbësore të përcaktohet pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal.

**Pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal është një proces që u mundëson të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin vendime së bashku për politikën dhe programet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e formësojnë jetën e të rinjve në një komunë të caktuar, gjegjësisht në një njësi të vetëqeverisjes lokale.**

Në Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, pjesëmarrja formale e të rinjve në nivel lokal parashihet përmes **Këshillit Rinor Lokal**. Këshilli Rinor Lokal është organ që funksionon në kuadër të komunës, gjegjësisht njësisë së vetëqeverisjes lokale, dhe që përbëhet nga të rinj<sup>6</sup>. Funksioni i Këshillit Rinor Lokal është i dyfishtë – **këshillëdhënës** dhe **përfaqësues**. Kjo do të thotë se ky organ mund të këshillohet nga Këshilli i komunës ose kryetari i komunës gjatë krijimit të politikave, gjegjësisht se ky organ mund të përfaqësohet para Këshillit të komunës ose para kryetarit të komunës për iniciativa dhe propozime të caktuara që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Lidhur me kompetencat specifike të Këshillit Rinor Lokal, sipas ligjit, ai mund:

- > të propozojë pika në rendin e ditës së Këshillit të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit që i prekin të rinjtë;
- > të iniciojë çështje për të rinjtë nga fusha e punës së komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin të Shkupit,
- > të iniciojë, të marrë pjesë dhe të japë informata kthyesë mbi procesin e strategjisë lokale për të rinjtë dhe politikat e tjera;
- > të paraqesë informacione në komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për çështje që lidhen me të rinjtë ; dhe
- > të kryejë punë të tjera këshilluese dhe përfaqësuese në përputhje me Ligjin.

Konkretisht, për pikën e parë, kjo do të thotë se anëtarët e Këshillit Rinor Lokal mund të propozojnë ndonjë pikë në rendin e ditës së Këshillit që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Për shembull, anëtarët e Këshillit Rinor Lokal të Qytetit të Shkupit mund të propozojnë pikë për diskutim në lidhje me ndotjen e madhe të ajrit në kryeqytet. Këshilltarët, nëse e votojnë për pikën si pjesë të rendit të ditës, kanë obligim të diskutojnë për këtë çështje, që paraqet hapin e parë drejt zgjidhjes së problemit dhe paraqet pjesëmarrjen fillestare të të rinjve në proceset që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor në nivel lokal.

Për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në nivel lokal, ligji parashikon edhe përgatitjen e një strategjie lokale për të rinjtë. Strategjia Lokale për të Rinjtë paraqet një dokument strategjik që përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe avancimin e interesave të të rinjve në nivel lokal dhe përcakton masat organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre. Strategjia përmban edhe Plan të veprimit për realizim me aktivitete të përcaktuara, dinamikat, bartësit e aktiviteteve dhe parashikimet e fondeve buxhetore, si dhe kushtet dhe treguesit e vlerësimit për zbatimin e Strategjisë Lokale për të Rinjtë, është e vlefshme për 5 vjet dhe miratohet nga Këshilli i komunës, përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit. Ajo përgatitet në bashkëpunim ndërmjet Këshillit të komunës, përkatësisht Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe Këshillit Rinor Lokal.

Konkretisht, ajo që duhet ditur në lidhje me këtë dokument është se ekziston mundësia që në vetë dokumentin të përcaktohen qëllime, prioritetet dhe aktivitete specifike që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Për shembull, Këshilli Rinor Lokal i Komunës së Tetovës mund të miratojë një strategji lokale rinore në të cilën parasheh se do të rrisë njohuritë e të rinjve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësor me atë që do të parashohë trajnime të rregullta për këtë temë me nxënësit e shkollave të mesme në komunën e Tetovës.

6 Sipas Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, të rinjtë janë personat e moshës prej 15 deri në 29 vjeç.

### 3.3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale është ligj që, ndër të tjera, i rregullon kompetencat e komunës dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje. Në interes të vetë udhëzuesit, vëmendje do t'i kushtohet vetëm kompetencave të komunës në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje.

#### 3.3.1. Kompetenca e komunës

Në përgjithësi, kompetenca e përgjithshme e komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, sipas Ligjit, përkufizohet si “tërësia e punëve me interes publik e me rëndësi lokale që në përputhshmëri me ligjin, Komuna ka të drejtë ti kryejë në territorin e vet dhe mban përgjegjësi për kryerjen e tyre”. Ndërsa, konkretisht, sipas Ligjit, komuna është kompetente për “mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës – masat për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimi jojonizues”. Nga kjo mund të konstatohet se çdo komunë ka obligim të kujdeset dhe ta përmirësojë mjedisin jetësor, si dhe të ndërmarrë masa të ndryshme për mbrojtjen e tij. Konkretisht, në aspektin e masave, komunat si njësi të vetëqeverisjes lokale, por edhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, me kërkesë të Qeverisë marrin masa për mbrojtjen dhe parandalimin e ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimi jojonizues.

#### 3.3.2. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në vendimmarrje

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, Ligji parashikon tre forma që mund të përdoren nga qytetarët. Ato janë: 1) iniciativa qytetare, 2) tubimi i qytetarëve dhe 3) referendumi. Më poshtë do të shpjegohet çdo formë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe si mund të përdoret për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

##### > Iniciativa qytetare

Qytetarët, gjegjësisht të rinjtë e një komune kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të miratojnë një akt të caktuar ose të zgjidhë një çështje të caktuar brenda kompetencës së tij. Këshilli është i detyruar të diskutojë për propozimin vetëm nëse atë e mbështesin të paktën 10% e zgjedhësve të komunës, gjegjësisht të vetëqeverisjes vendore të cilës i referohet çështja e përcaktuar. Për shembull, të rinjtë në Komunën e Ohrit janë të pakënaqur me numrin e madh të deponive ilegale rreth Liqenit të Ohrit, të cilat kanë pasoja katastrofale për vetë liqenin, por edhe për ajrin dhe tokën. Një grup të rinjsh duan të parashtrojnë një iniciativë qytetare në Këshillin e Komunës së Ohrit, të cilit do t'i propozojnë shtimin e numrit të inspektorëve të mjedisit jetësor në komunë. Ata mund ta bëjnë këtë duke u dhënë fizikisht ose online banorëve të Komunës së Ohrit hapësirë ku do të nënshkruhen në mbështetje të iniciativës. Nëse ky propozim mbështetet ose, në rastin konkret, nënshkruhet nga të paktën 10% e zgjedhësve të komunës, atëherë komuna ka detyrim të diskutojë në lidhje me këtë iniciativë dhe të vendosë për të.

##### > Tubimi i qytetarëve

Tubimi i qytetarëve paraqet formën e dytë të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, përkatësisht të rinjve në kuadër të komunës së tyre. Ai mund të thirret nga kryetari i komunës me iniciativën e tij, me kërkesë të Këshillit ose me kërkesë të të paktën 10% të zgjedhësve të komunës. Për sa i përket vetë tubimit, organet e komunës janë të obliguara që në afat prej 90 ditësh t'i shqyrtojnë përfundimet e miratuara në tubimin e qytetarëve dhe t'i marrin parasysh gjatë marrjes së vendimeve dhe sjelljes së masave lidhur me çështjet të



cilave u referohen, por dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e veta. Nëse në tubimin e qytetarëve të Komunës së Velesit miratohen konkluzionet në bazë të një analize të caktuar, në të cilat konstatohet se cilësia e ujit të lumit Vardar është në nivel jashtëzakonisht të ulët dhe se nevojitet një masë që do kontribuojnë në pastrimin e ujërave të zeza që derdhen në lumin Vardar, atëherë këto konkluzione do të duhet të merren parasysh nga Këshilli i Komunës së Velesit kur të vendos për këtë çështje, përkatësisht për këtë problem.

#### > Referendumi

Referendumi paraqet formën më të lartë dhe më të fortë të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në kuadër të komunës. Këshilli është i detyruar të shpallë referendum me kërkesë të së paku 20% të zgjedhësve të komunës ose këtë mund ta bëjë me iniciativë të tij. Ajo që është jashtëzakonisht e rëndësishme është se vendimi i marrë në referendum është i detyrueshëm për Këshillin. Për shembull, me kërkesë të 20% të zgjedhësve në Komunën e Gjevgjelisë, Këshilli shpall referendum në lidhje me atë se a duhet komuna t'i subvencionojë panelet fotovoltaike për amvisëritë në Komunën e Gjevgjelisë. Nëse referendumi është i suksesshëm si në aspektin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në referendum, ashtu edhe në aspekt të vendimit, atëherë ai vendim është i detyrueshëm për Këshillin e Komunës së Gjevgjelisë dhe ai ka për detyrë të sigurojë subvencione për panelet fotovoltaike.

#### > Parashtrësas dhe propozimet

Në përputhje me ligjin, çdo qytetar ka të drejtë, individualisht ose së bashku me të tjerët, të dorëzojë parashtrësas dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës komunale. Kryetari i komunës është i obliguar më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimi të parashtrësës, përkatësisht propozimit, parashtruesit t'i dorëzojë përgjigje me arsyetim. Për shembull, një grup të rinjsh nga Komuna e Gazi Babës mund t'i parashtrojnë një propozim kryetarit të Komunës së Gazi Babës për të ndërtuar më shumë shtigje për biçikleta. Këtij propozimi konkret, kryetari i komunës është i obliguar që t'i përgjigjet në afat prej 60 ditësh.

### 3.4. Ligji për Mjedisin Jetësor

Me Ligjin për Mjedisin Jetësor rregullohen të drejtat dhe obligimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, si dhe të drejtat dhe obligimet e personave juridikë dhe fizikë në sigurimin e kushteve për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për një mjedis jetësor të shëndetshëm. Ky ligj i obligon njësitë e vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komunat, që nga buxhetet e tyre të sigurojnë mjete financiare për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor. Më poshtë janë dhënë disa mundësi kyçe për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse për mbrojtjen e mjedisit jetësor që i parasheh ky ligj.

#### > Raporti për gjendjen e mjedisit jetësor

Në kuadër të Ligjit, parashikohet që vetë komunat të mund të miratojnë raport për gjendjen e mjedisit jetësor. Mirëpo, për shkak se ligjvënësi e përdor fjalën "mund", do të thotë se ky nuk është detyrim për komunën, por është e drejtë e tyre diskrecionale nëse do ta bëjnë këto ose jo. Kjo paraqet një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë dhe organizatat rinore që përmes formave të organizimit të të rinjve në nivel lokal, p.sh. Këshillit Rinor Lokal, të iniciojnë që komuna të fillojë me praktikën e përgatitjes së raporteve për gjendjen e mjedisit jetësor në komunë.

## > Plani lokal i veprimit për mjedisin jetësor

Në kuadër të Ligjit është paraparë përgatitja e planeve lokale të veprimit për mjedisin jetësor, përkatësisht plani për mjedisin jetësor i komunës përkatëse. E rëndësishme në lidhje me këtë plan është që Këshilli i komunës të formojë një organ të kryesuar nga Kryetari i komunës, detyra e të cilit është të monitorojë zbatimin e planit lokal të veprimit për mjedisin jetësor dhe të propozojë ndryshime në planin lokal të veprimit për mjedisin jetësor. Ky organ paraqet një mundësi të shkëlqyer për përfshirjen e anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal, ku ata do të mund ta monitorojnë drejtpërdrejt zbatimin e planit dhe të marrin pjesë në punën e organit. Lidhur me procedurën e përgatitjes së këtij plani, komunat, për hir të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, janë të obliguara që ta informojnë opinionin për të gjitha propozimet për përgatitjen, miratimin, ndryshimin apo rishikimin e planeve dhe programeve. Komunat e njoftojnë publikun nëpërmjet njoftimeve publike ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, si p.sh. mediat elektronike dhe të shkruara. Po ashtu, komunat janë të obliguara t'i ofrojnë publikut qasje në informacionet rreth propozimeve, duke përfshirë edhe informacionin për të drejtën e publikut për të marrë pjesë në procedurën e vendimmarrjes për planet dhe programet dhe organit kompetent të cilit mund t'ia parashirojnë vërejtjet dhe pyetjet e tyre. Kjo do të thotë se qytetarët, dhe mbi të gjitha të rinjtë, kanë mundësi të marrin pjesë në krijimin e këtij dokumenti, ndërsa nga ana tjetër komunat kanë detyrimin që publikut t'ia sigurojnë të drejtën për t'i shprehur vërejtjet, propozimet dhe mendimet e tyre para se të merren vendimet për planet dhe programet, por janë të detyruar t'i marrin parasysh mendimet e publikut gjatë marrjes së vendimeve. Në fund, me rastin e marrjes së vendimeve për planet dhe programet, komunat janë të obliguara që të marrin masa për informimin e publikut për vendimet e marra, si dhe për arsyet dhe bazat në të cilat bazohen ato vendime, duke përfshirë edhe informimin për procesin e pjesëmarrjes së publikut.

Për sa i përket përmbajtjes së planit lokal të veprimit për mjedisin jetësor, sipas Ligjit, ai përmban masa dhe aktivitete afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njerëzve që janë me interes dhe në kompetencë të komunës, e në veçanti për:

- 1 mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- 2 furnizimin me ujë të pijshëm cilësor në sasi të mjaftueshme;
- 3 mbrojtjen e ujërave nga ndotja, pastrimin e ujërave të zeza, zvogëlimin progresiv të shkarkimeve të dëmshme dhe eliminimin gradual të emetimeve të substancave të rrezikshme në ujëra dhe për të zbutur pasojat e efekteve të dëmshme të ujërave dhe mungesës së ujit;
- 4 menaxhimin e mbeturinave;
- 5 mbrojtjen nga zhurma dhe dridhjet që lindin si rezultat i veprimtarive dhe aktiviteteve ekonomike dhe të tjera;
- 6 zhvillimin urban dhe planifikimin hapësinor;
- 7 zhvillimin e transportit publik lokal dhe komunikacionit në territorin e komunës;
- 8 rritjen e efikasitetit të energjisë;
- 9 zhvillimin e turizmit ekologjik-kulturor dhe ndikimin e tij në mjedisin jetësor;
- 10 mbrojtjen e biodiversitetit;
- 11 menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- 12 ngritjen e vetëdijes së publikut dhe zhvillimin e arsimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
- 13 pasojat e zhvillimit ekonomik mbi mjedisin jetësor dhe
- 14 organet kompetente për zbatimin e elementeve të veçanta të planit.

### 3.5. Ligji për Mbikëqyrjen Inspektuese në Mjedisin Jetësor

Ligji për Mbikëqyrjen Inspektuese në Mjedisin Jetësor është ligj që e rregullon planifikimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese në mjedisin jetësor. Sipas Ligjit, mbikëqyrja inspektuese në mjedisin jetësor kryhet në nivel qendror dhe lokal. Në nivel qendror, mbikëqyrjen inspektuese e kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, ndërsa në nivel lokal mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë inspektorët e mjedisit jetësor në nivel lokal që vijnë nga komunat. Sa i përket mbikëqyrjes inspektuese, të cilën e kryejnë inspektorët, ajo mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Në interes të qëllimit të udhëzuesit, vëmendje do t'i kushtohet vetëm mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese si një lloj mbikëqyrjeje që ofron mundësinë e përfshirjes së qytetarëve.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme inspektuese kryhet sipas detyrës zyrtare ose në **bazë të denoncimit/iniciativës së paraqitur nga një person fizik ose juridik**, organ i administratës shtetërore ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe nga Qyteti i Shkupit, me urdhër të Këshillit Inspektues, si dhe me urdhër me shkrim të ministrit, drejtorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor, gjegjësisht, personi udhëheqës i shërbimit inspektues, gjegjësisht kryetari i komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në përbërjen e të cilit gjendet njësi organizative për kryerjen e mbikëqyrjen inspektuese në mjedisin jetësor në nivel lokal, nëse:

- > janë parashtruar denoncime dhe iniciativa që tregojnë ekzistencën e kërcënimeve për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve;
- > ka ndodhur ose kur ekziston rreziku i një aksidenti ose incidenti, i cili mund të ketë ndikim në mjedisin jetësor he në shëndetin e njerëzve;
- > janë fituar njohuri se ka pasur shkelje të kushteve të përcaktuara në dispozitat ose aktet që e rregullojnë kryerjen e veprimtarisë dhe/ose aktivitetit për shkak të ndikimit negativ të tyre mbi mjedisin jetësor;
- > është e nevojshme të merren masa shtesë për zbatimin e dispozitave nga fusha e mjedisit jetësor;
- > bëhen ndryshime në dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor me të cilat ndryshohen kushtet e kryerjes së veprimtarisë dhe/ose aktivitetit dhe
- > në përputhje me ligjin parashikohet se është e nevojshme të kryhet mbikëqyrje inspektuese për lëshimin, ndryshimin ose rishikimin e aktit që e rregullon kryerjen e veprimtarisë ose në çdo rast tjetër të përcaktuar me ligj.

Gjithashtu, çdo person fizik që ka dijeni se ka rrezik për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut mund ta raportojë këtë edhe në stacionin e policisë. Prandaj, shihet se edhe personi fizik si i tillë mund të paraqesë denoncim, gjegjësisht iniciativë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese nëse konsideron se një subjekt i caktuar (person fizik apo juridik, gjegjësisht individ apo firmë/kompani/fabrikë) kontribuon në rrezikimin e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njeriut.

## 4. SI MUND TË PËRFSHIHEN TË RINJTË NË MËNYRË AKTIVE NË PROCESET E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR NË NIVEL LOKAL?

Përfshirja e të rinjve në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe luftës kundër ndryshimeve klimatike është e një rëndësie të jashtëzakonshme. Ndikimet e ndryshimeve klimatike janë një shqetësim i madh për të rinjtë në mbarë botën. Nëpërmjet lëvizjeve të ndryshme rinore globale, kombëtare dhe lokale, të rinjtë e ngrenë zërin e tyre dhe avokojnë për pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike. Të rinjtë bëjnë përpjekje për të krijuar mekanizma, gjegjësisht mjete që do t'u japin atyre mundësinë për të kontribuar në krijimin, zbatimin dhe rishikimin e politikave të gjelbra. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të shumta nga të rinjtë në mbarë botën, qeverive ende u mungon vullneti politik dhe mirëkuptimi për t'i përfshirë të rinjtë në këto procese të rëndësishme. Prandaj, pavarësisht qëllimeve të mira, pjesëmarrja e të rinjve shpesh përfundon në formën e tokenizmit, ku pjesëmarrja e tyre është marginale, sipërfaqësore ose inekzistente. Duke pasur parasysh këtë, e veçanërisht duke pasur parasysh situatën e mjedisit jetësor në vendin tonë, është e nevojshme që të rinjtë, si agentë dhe promovues të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe luftës kundër ndryshimeve klimatike, të jenë ata që do të përfshihen në mënyrë aktive në këto procese të ashtuquajtura "të gjelbra".

Para se të hyjmë në detaje se si të rinjtë mund të përfshihen në proceset e mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel lokal, është e nevojshme të përkufizohet termi *pjesëmarrje e të rinjve*.



**Pjesëmarrja e të rinjve është një proces që u mundëson të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin vendime përbashkëta për politikën dhe programet që e formësojnë drejt-përdrejt ose indirekt jetën e të rinjve.**

Kur flasim për pjesëmarrjen e të rinjve, është jashtëzakonisht e rëndësishme të kemi parasysh edhe shkallën e Roxher Hartit<sup>7</sup>, që i referohet shkallës së pjesëmarrjes së të rinjve. Përmes tabelës mund të shihet: 1) se në çfarë shkalle është pjesëmarrja aktuale e të rinjve në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe 2) deri në çfarë shkalle duhet të synohet.

7 Në dispozicion në këtë link: [https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/childrens\\_participation.pdf](https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/childrens_participation.pdf)






Figura nr. 1 Shkalla e niveleve të pjesëmarrjes së të rinjve e zhvilluar nga Roxher Harti

## 4.1.1. Përshkrimi i shkallës së pjesëmarrjes së të rinjve

### Shkalla 8: Vendimmarrja e përbashkët

Projekte apo ide të iniciuara nga të rinjtë, të cilët i inkurajojnë të rriturit të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes si partnerë.

### Shkalla 7: I iniciuar dhe i iniciuar nga të rinjtë

Projekte apo ide të iniciuara drejtpërdrejt nga të rinjtë. Të rriturit mund të përfshihen për të ofruar mbështetjen e nevojshme, por projekti mund të realizohet edhe pa ndërhyrjen e tyre.

### Shkalla 6: I iniciuar nga të rinjtë, vendimmarrje e përbashkët me të rinjtë

Proceset iniciohen nga të rriturit, por të rinjtë ftohen në vendimmarrje dhe marrin përgjegjësi si partnerë të barabartë.

### Shkalla 5: Të konsultuar dhe të informuar

Projekte që iniciohen dhe realizohen nga të rriturit, ndërsa të rinjtë japin këshilla dhe propozime dhe informohen se si këto propozime kontribuojnë në vendimet apo rezultatet përfundimtare.

### Shkalla 4: Të emëruar, por të informuar

Projekte të iniciuara dhe të zbatuara nga të rriturit, ndërsa të rinjtë ftohen të marrin role apo detyra të caktuara në kuadër të projektit dhe janë të vetëdijshëm për ndikimin që e kanë në realitet.

### Shkalla 3: Tokenizmi

Të rinjtë kanë disa role në kuadër të projekteve, por ata nuk kanë ndikim real në asnjë vendim. Ekziston një pasqyrë e rreme (me dashje ose pa dashje) se të rinjtë marrin pjesë kur në fakt nuk kanë zgjidhje për atë se çfarë bëjnë dhe si e bëjnë atë.

### Shkalla 2: Dekorimi


Të rinjtë janë të nevojshëm në këtë proces për t'i përfaqësuar të rinjtë si një grup i pafavorizuar. Ata nuk kanë ndonjë rol të rëndësishëm, por si edhe çdo dekorim vendosen në një vend të dukshëm në kuadër të një projekti apo organizate në mënyrë që të dallohen lehtësisht nga jashtë.

### Shkalla 1: Manipulimi

Të rinjtë janë të ftuar të marrin pjesë në projekt, por ata nuk kanë ndikim real në vendimet dhe rezultatet. Në fakt, prania e tyre përdoret për të arritur disa qëllime të tjera, siç janë për shembull, fitimi i zgjedhjeve lokale, ofrimi i një pasqyre më të mirë për një institucion etj.

Pjesëmarrja e të rinjve mund të jetë formale dhe joformale. Në aspektin formal, mjafton të shikohet pjesa që analizon ligjet specifike që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Për sa i përket pjesëmarrjes joformale, ajo përfaqëson një lloj pjesëmarrjeje që nuk parashikohet me ndonjë akt të caktuar. Më shpesh, pjesëmarrja joformale e të rinjve lind nga nevoja e qartë për përfshirjen e të rinjve në një proces të caktuar nga vetë institucioni ose nga vetë të rinjtë. Pjesëmarrja joformale e të rinjve mund të realizohet individualisht, në grup ose përmes një shoqate qytetare.

## 4.1.2. Hapat për zgjidhjen e problemit në komunën time



## 5 Informimi dhe sensibilizimi i publikut




## 6 Vendosija e kontaktit me institucionin relevant



## 7 Prezantimi dhe krijimi i zgjidhjeve/masave të përbashkëta



## 8 Plani i veprimit




Në tabelën më poshtë janë shpjeguar të gjitha hapat përmes një shembulli praktik:

| Emri i iniciativës   | Për ajër të pastër në Tetovë! – grup joformal i qytetarëve  |
|--|---|
| <p><b>Definimi i problemit</b></p>                      | <p>Në vitin 2017, Organizata Botërore e Shëndetësisë vë në dukje se 6 nga 10 qytetet më të ndotura në Evropë (me përjashtim të Turqisë) janë në Ballkan, ndërsa Tetova është në krye të kësaj liste. Sipas Bankës Botërore, në Maqedoninë e Veriut 1.350 njerëz e humbasin jetën çdo vit si pasojë e ndotjes nga grimcat e imëta.</p>   |
| <p><b>Mbledhja e informacionit për problemin</b></p>    | <p>Që të mund të kalohet në hapat e mëtejshëm, është e detyrueshme të mblidhen informata në lidhje me problemin - burimin, pasojat dhe ndikimet e tij. Në rastin konkret, është e nevojshme të mblidhen informacione nga stacionet matëse në Tetovë për ndotjen e ajrit, raporte nga organizatat ndërkombëtare si p.sh. Banka Botërore dhe OKB-ja, pastaj raportet nga institucionet, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile. Një mjet i rëndësishëm në procesin e mbledhjes së informatave nga institucionet publike është Kërkesa për qasje në informatat me karakter publik (dokumenti 3, Shtojca 1). Kërkesa mund të dorëzohet me gojë, me shkrim ose në mënyrë elektronike (në një adresë e-maili). Institucioni që është posedues i informacionit është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës menjëherë, e jo më vonë se brenda 20 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës.</p> |
| <p><b>Konsultimi me ekspertë</b></p>                  | <p>Pas grumbullimit të të dhënave në lidhje me ndotjen, kalohet në konsultimin me ekspertët e fushës, në rastin konkret me ekspertët me njohuri në fushën e ndotjes së ajrit. Ekspertët e fushës zakonisht mund të gjenden në komunitetin akademik (universitete, fakultete, institute), organizata ndërkombëtare, si dhe në organizata të specializuara ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare. Ideja e këtij hapi është që këto konsultime fillimisht të kontribuojnë në një analizë më gjithëpërfshirëse të informacionit të mbledhur, por edhe të ndihmojnë në krijimin, gjegjësisht në formimin e argumenteve dhe zgjidhjeve të propozuara dhe politikave për zgjidhjen e problemit të ndotjes në Tetovë.</p>   |
| <p><b>Hartëzimi i institucioneve relevante</b></p>    | <p>Pasi të ketë përfunduar procesi i mbledhjes së informacionit dhe krijimit të argumenteve dhe propozim-zgjidhjeve/politikave, kalohet në hartëzimin e institucioneve relevante. Nën institucionet relevante në këtë shembull konsiderohen të gjitha ato institucione që me kompetencën dhe fuqinë e tyre mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemit të ndotjes në Tetovë. Si shembull, institucione relevante janë, mbi të gjitha, Këshilli i Komunës së Tetovës dhe Kryetari i komunës. Ideja është të hartëzohen vendet dhe kanalet adekuate ku mund të përcillen argumentet dhe zgjidhjet/politikat e propozuara.</p>   |
| <p><b>Informimi dhe sensibilizimi i publikut</b></p>  | <p>Për të rritur sensibilizimin e publikut, hapi tjetër është të bëhet informimi i tij për vetë problemin, gjegjësisht sa, kush kur ndot dhe cilat janë pasojat e ndotjes dhe, së dyti, çfarë, kush dhe kur duhet të bëjë diçka për të zgjidhur problemin. Ideja e këtij hapi është që publiku të jetë më mirë i njohur me problemin me të cilin përballet, duke pritur që ai të jetë më i vetëdijshëm dhe më aktiv në kërkesat e tij për zgjidhjen e problemit. Informimi i publikut mund të bëhet përmes mediave (dërgimit të komunikatave, mbajtjes së konferencave për shtyp, etj.), si dhe përmes mënyrave të tjera kreative që do të shpjegohen më poshtë.</p>  |



## Vendosja e kontaktit me institucionin relevant



Pas informimit të publikut, kur pritet që pjesa më e madhe e qytetarëve të jenë të vetëdijshëm për problemin e ndotjes dhe pasojat e tij, kalohet në vendosjen e kontakteve me komunën, si organi më relevant në nivel lokal që ka autoritetin dhe kompetencën për të zgjidhur problemin e ndotjes. Ideja e këtij hapi është t'i qasemi institucionit si partner, ku grupi do të mund ta ndihmojë atë në zgjidhjen e përbashkët të problemit. Vendosja e kontaktit mund të bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare të institucionit (në këtë rast komunës), me telefon, ose nëpërmjet kërkesës me shkrim për takim në arkivin e vetë institucionit. Në rastin konkret, mund të caktohet një takim me Kryetarin e komunës, sektorin përgjegjës për mjedisin jetësor në kuadër të komunës, si dhe me përfaqësues të grupeve koordinuese të këshilltarëve në kuadër të vetë komunës.

## Prezantimi dhe krijimi i zgjidhjeve/masave të përbashkëta



Pas vendosjes së kontaktit me komunën, kalohet në hapin përfundimtar, që është takimi me institucionin relevant, ku do të paraqiten argumentet dhe do të kërkohet mbështetje për krijimin e masave specifike. Në takim është e nevojshme të prezantohen argumentet dhe zgjidhjet/politikat e propozuara të zhvilluara nga ana e grupit. Është e nevojshme të prezantohet pse problemi është serioz, si ndikon mbi popullatën, dhe si ndikojnë masat e propozuara nga grupi në zgjidhjen e problemit. Nëse institucioni relevant i pranon zgjidhjet/masat/politikat e propozuara, atëherë grupi ka një fillim të mbarë dhe do të duhet të jetë vazhdimisht në koordinim me institucionin, por do të duhet të mbikëqyrë edhe se sa është realizuar ajo që është premtuar. Nëse institucioni relevant nuk i pranon zgjidhjet, gjegjësisht propozim-masat/politikat, atëherë kalohet në risensibilizimin dhe informimin e publikut me synimin për të ushtruar presion indirekt mbi bartësit e pushtetit, si dhe për vazhdimin e dialogut me institucionin relevant me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje kompromisi.

### 4.1.3. Mjete kreative për aktivizëm të gjelbër rinor




Burimi: Robert Kneschke/EyeEm/GettyImages

# 1

#### STENSILI

Një shabllon prej letre, plastike, druri ose metali me shkronja ose dizajne të prera në të, të cilat kopjohen në një sipërfaqe sipas dëshirës duke aplikuar pigment (ngjyrë, sprej ose të ngjashme).



Burimi: UNICEF MK

# 2

#### MURALI

Çdo pjesë e artit grafik që është pikturuar drejtpërdrejt në një mur, tavan ose sipërfaqe tjetër të përhershme, zakonisht në përmasa të mëdha. Teknikat e muraleve përfshijnë afresk, mozaik, grafite dhe marulflazh.



Burimi: <https://www.vecteezy.com/members/joiedevivre>

# 3

#### NGJITËSET

Ngjitëse kreative që kanë një histori të gjatë dhe i kanë rrënjët në kulturën dhe aktivizmin e rrugës. Ato janë shoqëruar me termin "aktivizëm gueril" për të përshkruar publikimin e mesazhit në mënyra "shqetësuese" që janë të lira, efektive dhe që i befasojnë njerëzit.

## 4

**FOTOGRAFIA dhe VIDEOJA**

Disa gjëra nuk mund të thuhën me fjalë, prandaj fotografia dhe videot janë një nga mjetet më të popullarizuara që përdoren në avokimin për ndryshimin e vetëdijes shoqërore. Shpesh, sidomos në rrjetet sociale, mund të shihni foto të fuqishme dhe video të shkurtra të protestave, luftërave, aksioneve aktiviste e të ngjashme.

Burimi: Faktor.mk



Извор: Младински образовен форум (МОФ)

## 5


**INSTALIMET NË HAPËSIRË PUBLIKE**

Përgatitja e sendeve, objekteve të ndryshme etj. nga materiale si plastika, goma, stiropori, druri etj., të cilat vendosen në ambiente publike dhe e tërheqin vëmendjen e kalimtarëve.

## 6

**PERFORMANCAT ARTISTIKE**

Shfaqje muzikore ose aktrimi në hapësira publike ose në skenë, të cilat përmes një mënyre kreative do ta informojnë popullatën për problemin specifik dhe do ta nxisin atë për një aktivizëm më të madh personal në zgjidhjen e problemit.





## 7

**PETICIONET ONLINE**

Peticione që krijohen në ueb-faqe të caktuara, më së shpeshti në Change.org, të cilat nënshkruhen online dhe shpërndahen në rrjetet sociale. Avantazhi i këtij mjeti është se ai mund të jetë i qasshëm për një numër sa më të madh qytetarësh, kështu që procesi i mbledhjes dhe i mobilizimit të mbështetjes për një qëllim ose kauzë të caktuar është shumë më i lehtë. Në vitin 2016, në platformën online Change.org u shfaq një petition nga qytetarët e R. të Maqedonisë së Veriut për ndalimin e ndërtimit të Rrotës panoramike në qendër të Shkupit. Peticionin për një kohë të shkurtër e nënshkruan më shumë se 7.800 nënshkrues nga dhjetori i vitit 2016 deri në janar të vitit 2017. Këshilltarët në Komunën e Qendrës gjatë vitit 2017 votuan anulimin e PDU-së "Ringu i vogël", pas të cilit është dashur të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore të objekteve në pjesët kontestuese të komunës, ku bënte pjesë edhe Rrota panoramike. Gjatë vitit 2021 u krijua një petition online që kërkonte ndalimin e "tërbimit urban" dhe ndërtimit të një objekti pranë hotelit "Holiday Inn", një petition online për tekstet shkollore dhe orë me prezencë fizike dhe një petition online për mbylljen e Kopshtit Zoologjik në Manastir, i cili rezultoi i suksesshëm dhe me të u arrit numri i nevojshëm i nënshkruesve, i cili më pas u dorëzua Këshillit të komunës.

## your government writing its climate policy



Burimi: <https://www.instagram.com/yfoememes/>

## 8

**MEMET**

Një lloj fotografie e redaktuar që shpërndahet në rrjetet sociale, e cila synon ta portretizojë problemin në mënyrë humoristike dhe/ose sarkastike.

## 9

**BLOGET**

Forma të gazetarisë qytetare që paraqesin forume ku çdo qytetar mund të shkruajë një tekst për një problem të caktuar dhe ta informojë publikun për të.

## 10

**FUSHATAT ONLINE**

Krijimi i një fushate online duke ndarë informacione specifike, fotografi, etj. për një problem të caktuar, duke përdorur # (shenjën e hashtag-ut).



## 5.1.1. SHTOJCA 1

Parashtruesi i kërkesës:

Deri te: Institucioni  
Drejtoria  
Sektori

# KËRKESË

**Lënda:**

Përmbajtja e kërkesës (për cilat nevoja parashtrojmë kërkesë në institucionin, drejtorinë, sektorin kompetent. Kërkesa i referohet çështjeve që na takojnë në përputhje ligjin dhe institucionet kanë detyrimin t'i përmbushin.)

Në: (vendi) \_\_\_\_\_, (data) \_\_\_\_\_

Parashtruesi i kërkesës

## 5.1.2. SHTOJCA 2

### FORMULARI PËR DORËZIMIN E PARASHTRESËS/REAGIMIT

**Parashtruesi:** Emri dhe mbiemri  
Të dhënat për kontakt:  
Adresa postare/adresa e e-mailit  
dhe/ose numri i telefonit  
(për të dorëzuar përgjigjen)

**Emri i subjektit të cilit i referohet parashtresa/reagimi (njësia e vetëqeverisjes lokale, institucioni e të ngjashme)**

**Data dhe periudha (ora e transmetimit ose e ritransmetimit) të cilës i referohet parashtresa/reagimi**

**Përshkrimi**

(Shpjegoni më në detaje se me çka saktësisht ka të bëjë reagimi juaj)

Data dhe vendi i parashtrimit

Nënshkrimi i kërkuesit



## 5.1.3. SHTOJCA 3

# KËRKESË PËR QASJE NË INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK

### Nga:

(shënohen të dhëna për Kërkuesin:  
Titulli, emri dhe mbiemri, adresa, telefoni, faksi, e-maili)

### Deri te:

(poseduesi i informacionit)

### Përfaqësuesi/avokati i kërkuesit të informacionit:

(shënohen të dhënat për përfaqësuesin/avokatin e mundshëm të kërkuesit: titulli, emri dhe mbiemri, adresa, telefoni, faksi, e-maili)

Në bazë të nenit 4 dhe nenit 12 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/2019), nga Poseduesi e kërkoj informacionin e mëposhtëm publik:

(përshkrimi i informacionit që kërkohet)

Mënyra se si Kërkuesi dëshiron të njihet me përmbajtjen e informacionit të kërkuar:

a) qasje në informacion   b) transkript   c) fotokopje   d) regjistrim elektronik   e) tjetër

(shënohet metoda e kërkuar, me rrumbullakim)

Mënyra e dorëzimit të informacionit:

a) me postë   b) telefon   c) faks   d) e-mail   e) tjetër

(shënohet metoda e kërkuar, me rrumbullakim)

Këshillë juridike: Kërkuesi nuk është i detyruar të shpjegojë kërkesën, por është e nevojshme të theksojë se bëhet fjalë për Kërkesë për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

**Nënshkrimi**

Në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_. viti 202\_\_.

(nëse kërkesa dorëzohet në formë letre)



Проектот е финансиран од Европската унија



**МЛАДИНСКИ АКТИВИЗАМ**  
#ЗА ПОЗЕЛЕНИ ОПШТИНИ



МЗМП



GoGreen



SHJRM

Rr. "Donbas" nr. 14/1-6, 1000 Shkup

Telefoni: 02/3220-870

E-mail-i: [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)

Ueb-faqja: [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk)